



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1764/1 prot.,

Datë 04.07.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AEE SERVICE” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për secilin lot do të shpallet një operator ekonomik fitues.”, me Nr. REF-50051-06-03-2025, me objekt: Loti 2:“Mirëmbajtje automjete për Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë”, me fond limit 5,500,000 (pesë milion e pesëqind mijë)lekë pa TVSH zhvilluar më datë 16.06.2025, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “AEE SERVICE” SHPK, me Nipt. L81530012C Adresa: Rruga dytësore, mbikalimi i Kasharit, objekt në zonën kadastrale 2105, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5516 datë 03.07.2025 dhe me Nr. 1764/2025 Prot., datë 03.07.2025 e operatorit “AEE SERVICE” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për secilin lot do të shpallet një operator ekonomik fitues.”, me Nr. REF-50051-06-03-2025, me objekt:Loti 2: “Mirëmbajtje automjete për Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë”, me fond limit 5,500,000 (pesë milion e pesëqind mijë)lekë pa TVSH zhvilluar më datë 16.06.2025, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AEE SERVICE” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsye e skualifikimit:

“Nuk permbush piken 2.3.3 të kapacitetit teknik për arsyen se ambjenti i paraqitur në permbushje të këtij kriteri nuk rezulton që të jetë të jetë i pajisur me Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirëmbajtja e pjeseve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç në reference të kriterit 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë.”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 04.07.2025

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro